



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000430/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda :** *Rekomandim për fillimin e hetimeve për ngjarjen e ndodhur me shtetasin E.Sh. në protestën e zhvilluar në qytetin e Tiranës në datën 16.03.2019, identifikimin e drejtuesve të automjeteve ujëhedhëse që kanë dëmtuar ankuesin dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare", parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.*

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**  
**Tiranë**

Me shkresat nr. K2/E25-3 prot., datë 26.03.2019, nr. K2/E25-6 prot., datë 21.05.2020 dhe nr. K2/E25-3 prot., datë 14.01.2021 ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi E.Sh. me banim në Berat. Ankuesi shkruan se në datën 16 mars 2019, së bashku me disa shokë të tij ndërmjet të cilëve A.K. dhe R.D. janë nisur nga Berati rreth orës 07:30 dhe kanë mbërritur në Tiranë rreth orës 10:30, tek kryqëzimi ku ka qenë "Shqiponja" për të marrë pjesë në protestën që do të organizohej atë ditë në kryeqytet. Pasi kanë zbritur nga automjeti ata janë nisur në këmbë deri tek Kryeministria dhe më pas kanë shkuar tek Parlamenti duke u bërë pjesë e protestës së zhvilluar atë ditë në qytetin e Tiranës. Sipas tij, gjatë kohës së zhvillimit të protestës ai dhe shokët e tij nuk ka bërë veprime të kundërligjshme, nuk kanë provokuar e goditur me gurë ose sende të tjera punonjësit e policisë, makinat e tyre apo godinat qeveritare. Në një moment kur ata ndodheshin së bashku me protestuesit e tjerë në pedonalen ndërmjet Qendrës Tregtare "Toptani" dhe portës hyrëse të Kalasë së Tiranës, kanë ardhur dy makina të policisë (autobote) me ujë dhe kanë hedhur ujë me presion ndaj protestuesve. Ai dhe A.K. janë larguar për t'u shmangur goditjes me ujë duke kaluar në drejtim të portës së kalasë. Por për shkak të hedhjes së ujit me presion të lartë ai është përplasur në rrugë dhe në tentativë për t'u ngritur i është hedhur përsëri ujë me presion. Në këtë çast është ndihmuar për t'u ngritur nga shoku i tij A.. Sipas tij, pasi është ngritur ka filluar të vjellë për shkak të dëmtimeve të pësuar nga goditja me ujë dhe përbërjes kimike të ujit pasi gjatë kësaj kohe ai ka gëlltitur ujë. Meqë nuk ndihej mirë për shkak të dhimbjeve që kishte në brinjë në krahun e djathtë dhe i merreshin mendë është ulur në trotuar. Duke parë gjendjen e tij shëndetësore, shokët që e shoqëronin, kanë njoftuar autoambulancën që ndodhej aty pranë. Ambulanca e ka marrë atë dhe shokun e tij A.K. dhe e dërguan në Spitalin e Traumës Tiranë. Në spital ai ka shkuar rreth orës 14:30 dhe është vizituar nga mjeku S.K.. Gjatë kohës së qëndrimit në spital i kanë bërë dy grafi të dorës, një skaner të shtyllës kurrizore

dhe ka marrë dy serume. Pas bërjes së ekzaminimeve mjeku i ka thënë se kishte krisur kërcet e dy unazave të shtyllës kurrizore. Në spital ai ka qëndruar deri në orët e darkës kur është larguar me dëshirën e tij dhe për këtë ka firmosur në regjistrin përkatës.

Sipas ankuesit, gjatë qëndrimit në spital kanë shkuar dy prokurorë, të cilët e kanë marrë në pyetje lidhur me ngjarjen e ndodhur me të. Ndërkohë atij i kanë dhënë edhe një vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Klevis Çifligu si dhe letra e të drejtave të viktimës. Fotokopjet e këtyre dokumenteve ankuesi i ka depozituar së bashku me ankesën.

Pas marrjes së ankesës së shtetasit E.Sh., në vijim të kryerjes së hetimit administrativ nga punonjësi i institucionit tonë u janë marrë deklarime shtetasve A.K., R.D. dhe G.A. të cilët kishin dijeni lidhur me ngjarjen e ndodhur me ankuesin. Këta persona u pyetën me procesverbal dhe në deklaratimet e tyre informuan se kanë qenë në protestën e organizuar në Tiranë në datën 16.03.2019. Sipas tyre, shtetasi E.Sh. dhe ata kishin qenë paqësorë dhe nuk kishin kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm. Gjithashtu ata deklaruan se e kanë parë ngjarjen e ndodhur me E. ku ai është goditur dy herë nga makinat e policisë me ujë me presion. Për shkak të goditjes së fortë ai ishte rrëzuar në tokë dhe kishte pësuar dëmtime në trup. Përveç sa më sipër, ata deklaruan se e kishin shoqëruar atë për në Spitalin e Traumës.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese me shkresat nr. K2/E25-3 prot., datë 26.03.2019, nr. K2/E25-6 prot., datë 21.05.2020 dhe nr. K2/E25-3 prot., datë 14.01.2021 ju kërkuaq informacion lidhur me sa më poshtë:

1. Nëse nga organi juaj është regjistruar ndonjë procedim penal për ankesën e shtetasit E.Sh. ose ndaj tij?
2. Nëse po, në çfarë date, mbi çfarë baze, numri dhe vepra penale për të cilin është regjistruar ai, si dhe në çfarë faze ndodhet hetimi i këtij procedimi penal?
3. A është kryer akti i ekspertimit mjeko-ligjor i shtetasit E.Sh. dhe nëse po, a është administruar ai nga ana juaj dhe çfarë lloje dëmtimesh i janë shkaktuar atij?
4. Së bashku me informacionin ju kërkuaq të dërgonit edhe fotokopje të vendimit të marrë nga prokurori për regjistrimin e procedimit penal dhe të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të shtetasit E.Sh..

Pas tre kërkesave tona, nga organi juaj me shkresën nr.16121/1 prot., datë 20.01.2021 u informuaq se nga verifikimet e kryera në sekretari nuk rezulton të jetë regjistruar kallëzim penal nga shtetasi E.Sh. dhe as nga ndonjë Komisariat Policie në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Nga shqyrtimi i ankesës së shtetasit E.Sh. dhe deklaratimet e dhëna nga shtetasit A.K., R.D. dhe G.A. rezulton se ankuesi në datën 16.03.2019 ka marrë pjesë në protestën e organizuar në Tiranë para godinës së Kuvendit. Gjithashtu rezulton se ai është goditur me ujë me presion nga automjeti i policisë dhe nga kjo goditje ka pësuar disa dëmtime në pjesë të ndryshme të trupit. Për shkak të këtyre dëmtimeve ai është marrë me një autoambulancë dhe është dërguar në Spitalin e Traumës Tiranë ku i janë kryer disa ekzaminime mjekësore.

Po kështu nga deklaratimet e tij rezulton se në kohën kur ndodhej në këtë spital ai është pyetur nga dy prokurorë lidhur me ngjarjen e ndodhur me të.

Ndërsa nga vendimi “Për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor” të shtetasit E.Sh., fotokopjen e të cilit ankuesi na e ka dërguar së bashku me ankesën, rezulton se ky vendim është marrë nga oficeri i policisë gjyqësore i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Klevis Çifligu. Ky fakt provon se njëri prej personave që e kanë pyetur atë, që sipas tij ishin prokurorë, ka qenë oficeri i policisë gjyqësore Klevis Çifligu, efektiv i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në vlerësimin tonë, për deri sa ankuesit i është dhënë vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, atij duhet t’i jetë marrë apo duhet t’i ishte marrë edhe kallëzimi për ngjarjen e ndodhur.

Referuar përgjigjes së dërguar nga organi juaj rezulton se nuk është regjistruar ndonjë kallëzim penal i bërë nga shtetasi E.Sh. apo i dërguar nga Komisariatet e Policisë Tiranë.

Ndodhur para këtyre fakteve rezulton se atij nuk i është marrë kallëzimi penal për ngjarjen e ndodhur me të ose edhe nëse i është marrë kallëzimi, ai nuk është administruar konform akteve normative në fuqi duke bërë regjistrimin e tij dhe më pas kryer veprimet e nevojshme procedurale.

Nga ankesa e shtetasit E.Sh. dhe deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm rezulton se ankuesi ka pësuar dëmtime fizike për shkak të goditjes me ujë me presion të hedhur nga automjeti i policisë.

Nga monitorimi në vijimësi i protestave të ndryshme të organizuara nga subjekte politike, shoqata apo grupime qytetarësh kemi konstatuar që strukturat e Policisë së Shtetit përgatiten dhe miratojnë plane-masash për mbarëvajtjen e protestave dhe për shpërndarjen e tyre në rastet kur protestuesit kryejnë akte të dhunshme apo veprime të tjera të kundërligjshme që cenojnë rendin dhe sigurinë publike. Përveç planifikimit të punonjësve të policisë që vendosen me shërbim në vendin ku do të organizohet protesta, parashikohen edhe mjetet e pajisje të ligjshme të përdorimit të forcës të cilat do të përdoren në rast nevojë sikurse janë edhe automjetet ujëhedhëse, lëndët neuroparalizuese, etj.

Për të analizuar nëse veprimet e punonjësve të policisë janë kryer ose jo në përputhje me ligjin dhe nëse është zbatuar parimi ligjor i proporcionalitetit kur përdoren pajisjet dhe mjetet e përdorimit të forcës, i referohemi akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

**I.** Në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenin 99 parashikohet se:

*“1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të mbajë armë. Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*2. Punonjësit të policisë i jepen në përdorim mjete dhe pajisje të tjera nga ato të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të përcaktuara në Rregulloren e Policisë”.*

Në nenin 133 të këtij ligjit parashikohet se:

*“1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.*

*2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

*3. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete*

goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.

4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

5. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen”.

**II.** Ndërsa në VKM Nr.750, dt.16.09.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”, të ndryshuar, në nenet 54/1 dhe 110 parashikohet se:

Neni 54/1

“1. Punonjësit e Policisë pajisen me armatim, municion e pajisje për kryerjen e detyrave të ngarkuara, sipas funksionit organik, në përputhje me ligjin "Për armët".

Neni 110

“1. Punonjësi i Policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.

2. Punonjësi i Policisë, në çdo rast e përdor forcën pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe përdor gjithmonë mjete të përshtatshme në proporcion me rrezikun dhe qëllimet që synohen të arrihen.

3. Punonjësi i Policisë është përgjegjës individualisht për ushtrimin e forcës dhe jep llogari para ligjit”.

Nga përmbajtja e dispozitave të akteve normative të cituara më sipër rezulton se punonjësit e policisë kanë të drejtë që të përdorin forcën dhe mjetet e ligjshme në dispozicion për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Ndërkohë ata kanë detyrimin ligjor që ta përdorin forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Por, duke analizuar ankesën e shtetasit E.Sh. ashtu edhe nga deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm rezulton se nga punonjësit e policisë që kanë patur në përdorim automjetet ujëhedhëse në datën 16.03.2019 janë përdorur mjetet në dispozicion duke hedhur ujë me presion ndaj qytetarëve pa qenë i nevojshëm përdorimi i tyre dhe ndërkohë prej tyre nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit. Ankuesi dhe dëshmitarët e sipërpërmendur kanë qenë duke ushtruar një liri/të drejtë kushtetuese për të tubuar në mënyrë paqësore, të parashikuar nga neni 47 i Kushtetutës. Mos zbatimi i këtij parimi ka sjellë si pasojë dëmtime serioze të shëndetit të ankuesit.

Sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ankesa dhe deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm nuk rezulton që ankuesi dhe personat e tjerë që ndodheshin me atë në protestë të kryenin veprime që cenonin rendin dhe sigurinë publike apo të vinin në rrezik jetën e punonjësve të Policisë. Sipas dispozitave të cituara më sipër, punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri. Duke iu referuar parimit të proporcionalitetit për përdorimin e forcës, rezulton se në rastin në fjalë ka patur

kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur dhe tejkallim të përdorimit të forcës nga drejtuesit e automjeteve ujëhedhëse.

Ne vlerësojmë se veprimet e punonjësve të policisë (drejtuesve të automjeteve ujëhedhëse) përmbajnë elementët e veprës penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, të ndryshuar. Këto veprime kanë cenuar rëndë integritetin fizik të shtetasit E.Sh., të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Është rasti që të theksojmë edhe faktin se, ndonëse nga oficeri i policisë gjyqësore Klevis Çifligu, efektiv i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është marrë vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor të shtetasit E.Sh., ky veprim procedural i kryer nga ana e tij nuk është shoqëruar me veprime të mëtejshme me qëllim administrimin e deklarimeve/kallëzimit të ankuesit dhe vijimin e procedurës për hetimin e ngjarjes së ndodhur me të konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërkohë, vlerësojmë se këto veprime të punonjësve të policisë dhe të oficerit të policisë gjyqësore cenojnë rëndë imazhin e organeve pjesë e të cilave ata janë, si dhe dëmtojnë e trondisin thellë besimin e publikut tek këto organe të administratës shtetërore.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrate publike”,* dhe në nenin 21/ç të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale”,*

### **REKOMANDOJMË :**

1. Fillimin e hetimeve për ngjarjen e ndodhur me shtetasin E.Sh. në protestën e zhvilluar në qytetin e Tiranës në datën 16.03.2019, identifikimin e punonjësve të policisë (drejtuesve të automjeteve ujëhedhëse) që kanë dëmtuar ankuesin dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore për kryerjen e veprës penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.
2. Në kuadër të hetimit të këtij rasti të merren masat e nevojshme për të bërë të mundur kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të shtetasit E.Sh., si dhe pyetjen e tij dhe të dëshmitarëve të pranishëm.
3. Analizimin e rastit të mos administrimit konform dispozitave ligjore në fuqi të deklarimeve/kallëzimit të marra shtetasit E.Sh. nga oficerët e policisë gjyqësore efektiv të organit tuaj dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse.
4. Përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mospërsëritjen e tij në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë në cilësinë e provave fotokopje të njësuara të dokumentave të mëposhtme:

1. Ankesa e bërë nga shtetasi E.Sh. në datën 20.03.2019;
2. Procesverbali i pyetjes së shtetasit A.K.j në datën 20.03.2019;
3. Procesverbali i pyetjes së shtetasit R.D. në datën 20.03.2019;
4. Procesverbali i pyetjes së shtetasit G.A. në datën 20.03.2019;
5. Vendim “Për kryerjen e ekspertimit mjekologjor” të shtetasit E.Sh., datë 16.03.2019, përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore Klevis Çifligu.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**

Konceptoi: S. Nushi